

VENDIM
Nr. 639, datë 5.11.2025

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 289, DATË 17.5.2023, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, SI PJESË E FORCËS SHUMËKOMBËSHE DHE
VËZHguesve (*MULTINATIONAL FORCE AND OBSERVERS, MFO*), NË SINAI,
REPUBLIKA ARABE E EGJIPTIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3, e vendimit nr. 289, datë 17.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si pjesë e Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve (*Multinational Force and Observers, MFO*), në Sinai, Republika Arabe e Egjiptit”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri më 30.12.2029, me rotacion deri në 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditë, afat i cili fillon të llogaritet nga data e nisjes së personelit për në mision.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama